

**Njoftim për përqendrim me të cilin Volkswagen Aktiengesellschaft Wolfsburg,
Gjermani dhe Nikolaus (BC) Bidco GmbH Frankfurt mbi Main, Republika Federale e
Gjermanisë do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Everllence SE Augsburg,
Republika Federale e Gjermanisë
(lënda nr. 08-110/2026)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.06.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen Aktiengesellschaft)**, shoqëri aksionare, me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani dhe **Nikolaus (BC) Bidco GmbH (Nikolaus (BC) Bidco GmbH)**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Eschersheimer Landstraße 50-54, c/o Apex Corporate Products (Gjermani), 60322 Frankfurt mbi Main, Republika Federale e Gjermanisë do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë **Everllence SE (Everllence SE)**, Shoqëri publike evropiane me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Stadtbachstraße 1, 86153 Augsburg, Republika Federale e Gjermanisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Volkswagen Aktiengesellschaft është prodhues gjerman i automobilave dhe shoqëri zotëruese e Grupit Volkswagen ("Grupi Volkswagen").

Grupi Volkswagen është aktiv në nivel global, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të BE-së, kryesisht në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e veturave të udhëtarëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve turistikë, shasive për autobusë dhe motorëve me naftë, motoçikletave, secila duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesore. Grupi Volkswagen është aktiv edhe në shpërndarjen e automjeteve. Grupi Volkswagen përfshin markat e mjeteve motorike Volkswagen (Volkswagen), Volkswagen Commercial Vehicles (Volkswagen Commercial Vehicles), Porsche (Porsche), Audi (Audi), Škoda (Škoda), Bentley (Bentley), Lamborghini (Lamborghini), SEAT (SEAT), Cupra (Cupra), MAN (MAN), Scania (Scania) dhe Ducati (Ducati).

Për më tepër, Grupi Volkswagen ofron gjithashtu (i) shërbime financiare dhe shërbime sigurimi lidhur me shpërndarjen dhe financimin e automobilave dhe automjeteve komerciale të tij dhe (ii) zgjidhje energjetike dhe zgjidhje për karikim për konsumatorët e tij në kuadër të aktiviteteve të tij në fushën e elektromobilitetit.

Grupi Volkswagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të mëposhtme të varura:

- Porsche Leasing SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup dhe veprimtari prioritar 64.910 – Lizing financiar,
- Porsche Broker SHA Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup dhe veprimtari prioritar 66.220 – Veprimtari të agentëve të sigurimeve dhe ndërmjetësve të sigurimeve,
- Scania Maqedoni SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe veprimtari prioritar 46.710 – Tregti me shumicë e mjeteve motorike, dhe

- Porsche Maqedoni SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnja dhe Hercegovina nr. 4, Shkup dhe veprimtari prioritare 46.710 – Tregti me shumicë e mjeteve motorike, Shkup. Veprimtaritë prioritare të këtyre shoqërive në Maqedoninë e Veriut janë kryesisht tregtia me mjete motorike dhe lizingu financiar.

Nikolaus (BC) Bidco GmbH është shoqëri për qëllime të veçanta e themeluar për nevojat e Transaksionit të propozuar dhe nuk kryen veprimtari në Maqedoninë e Veriut.

Nikolaus (BC) Bidco GmbH kontrollohet nga fonde që menaxhohen dhe/ose që këshillohen nga Bain Capital. Bain Capital është kompani private investimi me seli të regjistruar në Boston, SHBA e cila investon në shoqëri nga shumë sektorë industrialë, duke përfshirë teknologjinë e informacionit, shëndetësinë, tregtinë me pakicë dhe produktet e konsumit të gjerë, komunikimet, shërbimet financiare, si dhe prodhimin industrial dhe industrinë përpunuese.

Everllence SE (emri i mëparshëm: MAN Energy Solutions SE), me seli në Augsburg (Gjermani), është shoqëri inxhinierike që operon në nivel global dhe është e specializuar për zgjidhjet e fuqisë dhe energjisë për sektorin detar, energjetik dhe industrial. Shoqëria zhvillon dhe prodhon motorë, turbomakineri dhe sisteme shtytëse, me fokus të veçantë në teknologjitë për dekarbonizim dhe zgjidhjet për përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Gjithashtu, Everllence ofron shërbime gjatë gjithë ciklit jetësor të produkteve të saj, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe optimizimin e performancës së tyre, përmes rrjetit të saj global të shërbimeve. Everllence dhe shoqëritë e saj të varura të kontrolluara, në tekstin e mëtejshëm, bashkërisht emërtohen si „Grupi Everllence“.

Në qershor 2025, MAN Energy Solutions SE zyrtarisht ndryshoi emrin e saj në Everllence SE. Everllence SE është shoqëri e varur e tërthortë në pronësi të plotë të Volkswagen dhe është pjesë e Grupit Volkswagen.

Everllence nuk ka shoqëri të varura të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon asnjë qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu përkatës i mallrave, në të cilat ka të bëjë përqendrimi janë: ***tregu i prodhimit dhe furnizimit me motorë; tregu i prodhimit dhe furnizimit me gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike; tregu i prodhimit dhe furnizimit me turbombushës; tregu i prodhimit dhe furnizimit me turbomakineri; dhe tregu i shërbimeve pas shitjes dhe shërbimeve teknike të lidhura me to për pajisje industriale dhe detare, duke përfshirë dhe turbomakineritë.***

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.07.2026

Shkup

